



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

-IV- Nr. l prot. 17 Më 23.01 2011
Br. prot. Dt. 23.01 2011
RAHOVEC - ORAHOVAC Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-032, të datës 29.08.2011, nenit 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068, neni 5, paragrafi c, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10 për Normativin e Kuadrit Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale për Arsim në Rahovec shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës me kuadër profesional të arsimit për vitin shkollor 2018/2019 në:

I. SHFMU "Dëshmorët e Zatriqit" në Zatriq

Një mësuesdhënëse/e të gjuhës angleze me 19 orë mësimore, me kohë të caktuar derisa të kthehet mësuesdhënësi nga pushimi i lehonisë.

II. SHFMU "Heronjtë e Kosovës" – Hoçë e Vogël/Brestoc

Një mësuesdhënëse/e të programit fillor, me kohë të caktuar, derisa të kthehet mësuesdhënësi nga pushimi i lehonisë.

III. SHFMU "Skënder Kastrati" në Radoste

Një mësuesdhënëse/e të lëndës së fizikës me 14 orë mësimore dhe me plotësim norme në SHML "Xhelal Hajda – Toni", me kohë të caktuar derisa të kthehet mësuesdhënësi nga pushimi i lehonisë.

IV. SHFMU "7 Shtatori" në Rahovec

Një mësuesdhënëse/e të artit figurativ me 16 orë mësimi, me kohë të caktuar.

Kushtet për konkurrim:

Për vendet e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U. A. 10/2018 (Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë. Aplikacionet merren dhe dorëzohen duke ia bashkëngjitur dokumentet përkatëse, në zyrat e DKA-së.


Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- Kopja e diplomës së fakultetit të kryer, e noterizuar,
- Kopjet e certifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë,
- Kopja e ekstraktit të lindjes,
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime.

Dokumentet pranohen deri më datë 06.02.2019, deri në orën 16:00. Intervistimi me shkrim i kandidatëve bëhet më 08.02.2019 në objektin e SHMLP “Selajdin Mullaabazi-Mici” në Rahovec, me fillim në orën 10:00. Intervistimi me gojë i kandidatëve bëhet më 11.02.2019, në DKA, me fillim në orën 10:00.

Rahovec

23.01.2019



Drejtori i DKA-së

Avni Morina

Avni Morina